



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR MAT

V E N D I M

Nr.3, datë 19/06/2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI TË
TJERA NË BRIGJET DHE SHTRATIN E BURIMIT UJOR PËR
PROJEKTIN, “NDËRTIM URE AUTO 2 HD 10M” ME
VENDNDODHJE, FSHATI KALUAR, NJËSIA ADMINISTRATIVE
UNGREJ, BASHKIA LEZHË**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të Ligjit Nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.550, datë 15.07.2020, “*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Lumor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë, për autorizim për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujqor për projektin, “Ndërtim Ure Auto 2 Hd 10m” me vendndodhje, Fshati Kaluar, Njësia Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.
2. Vendodhja e strukturave (koordinatat KRGJSH).

Ura në përroin e Ungrejt:

1.X-486278.7;	Y-4636514;	Z-204 m.m.n.d;
2.X-486296.5;	Y-4636526;	Z-204 m.m.n.d;
3.X-486281.5;	Y-4636510;	Z-204 m.m.n.d;
4.X-486300.1;	Y-4636521;	Z-204 m.m.n.d;

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL MAT

TAULANT MALSHI

